

Elif Arslan

DHUNA

DHE FËMIJËT TANË

Nga turqishtja:
Rehan Neziri

Kreuzlingen, 2024

Përmbajtja:

Hyrje.....	3
I. Fëmija si përjetues i dhunës	11
1. Dhuna fizike: rrahja, dajaku.....	11
2. Dhuna emocionale	24
3. Shembuj të dhunës emocionale ...	38
4. Fëmijët nën kthetrat e reklamave dhe mania e konsumit	42
II. Fëmija si dëshmitar i dhunës.....	48
1. Fëmija, dëshmitar i dhunës në shtëpi	48
2. Fëmija, dëshmitar i pamjeve të dhunës në media.....	51

Hyrje

Me sa emocione e me sa shpresa të mëdha pritet lindja e një fëmije... Ai është, sipas Kur'anit fisnik, drita e syve tanë... Bashkë me lindjen e tij rritet edhe barra, përgjegjësia dhe lodhja e prindërve. Mirëpo Krijuesi i Madh i ka pajisur ata me asi lloj force e dashurie, saqë edhe i rrinë me drithërima mbi kokë kësaj qenieje të voc-kël. Një foshnje e paaftë, e varur nga të tjerët, por po aq edhe e dashur dhe e këndshme. Tanimë ajo është në duart e nënës dhe të babait të saj.

Prindërit që janë të vetëdijshtë se fëmijët e tyre, përsëri që janë dritë e syve dhe burim i kënaqësisë prindërore, në të njëjtën kohë janë edhe mjet sprove,¹ nuk do të donin ta humbnin këtë provim. Besimtarët që e di-

¹ Kur'ani, et-Tegabun, 64:15.



në se Kur'ani dhe Muhammedi a.s. kërkojnë prej tyre që të bëhen me fëmijë, por edhe se ata në të njëjtën kohë janë edhe mjet sprove për ta, të bëhen me fëmijë nuk e shohin si synim të vetmin jetësor. Pas lindjes së fëmijës, synim parësor ata kanë rritjen e një fëmije të mirë. Ata e dinë se pas vdekjes, atyre u mbyllen regjistrat e veprave të tyre dhe se përjashtim kë-

tu bëjnë lutjet dhe veprat e mira që fëmijët e tyre do t'i bëjnë për ta.²

Ajo foshnje është bërë nijet me leje të Zotit (para marrëdhënieve intime) dhe pastaj janë bërë lutje për një fëmijë të mirë gjatë gjithë kohës sa ka qenë në bark të nënës. Të njëjtin kujdes për një rritje dhe zhvillim të shëndoshë fizik e shpirtëror, prindërit do ta vazhdojnë edhe pasi të ketë lindur foshnja. Mirëpo, pjesa më e rëndë e kësaj pune fillon pikërisht tani, pas lindjes. Me rëndësi është që në këtë proces të gjatë e të lodhshëm, të mos bëhen gabime; gabimet e bëra eventuale të përmirësohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Rritja e një fëmije që do të ishte i dobishëm për shoqërinë ku jeton dhe për vetveten, por edhe që do t'i shtonte hijeshi kësaj dhe botës tjetër, për prindërit që janë të vetëdijshëm për sprovën e mund-

² Muslimi, "Vasijeh", 14.

shme, sjell me vete edhe disa detyra e përgjegjësi.

Përgjegjësia e parë, gjetja e një emri me kuptim të bukur dhe me të cilin do të mburret nesër fëmija, menjëherë ua lë vendin përgjegjësive të tjera, si kujdesi për të, plotësimi i nevojave që ka, që nga momenti i ardhjes së tij në këtë botë. Dashuria, interesimi, edukimi dhe arsimimi i mirë dhe i shëndoshë i tyre, sjellja e mirë me vëllezërit e motrat, trajtimi i barabartë i të gjithë fëmijëve, shkollimi, aftësimi për ndonjë zanat, pajisja me shkathtësi, edukatë e me sjellje të mirë, shkurt edukimi i tyre ashtu siç duhet, kërkon që prindërit fillimisht vetë të jenë të kujdesshëm e të vëmendshëm si dhe të njoftohen mirë me botën e fëmijëve, me interesimet dhe nevojat e tyre, me strukturën e tyre shpirtërore. Vetëkuptohet se përgjegjësia e të qenit prind nuk përfundon me sjelljen në jetë të fëmijës si dhe me plotësimin e nevojave elementare

të tij si ushqimin, strehimin dhe veshmbathjen. Ato përbëjnë një gamë më të gjerë, duke i përfshirë natyrisht edhe këto.

Pejgamberi ynë i dashur Muhammedi a.s. ka thënë se dhurata më e mirë që prindi mund t'ia bëjë fëmijës së vet është edukimi i mirë.³ Edukata e mirë u hap derën shumë sendeve të bukura... Çdo prind ka dëshirë që fëmijës së vet t'i japë një edukatë të mirë. Një fëmijë i edukuar mirë, do të jetë i dobishëm për shoqërinë, për rrethin, për prindërit dhe për vetveten. Mirëpo, për fat të keq, pikërisht që nga kjo pikë, pra nga pika e edukimit të fëmijës, vërehen mjaft gabime të prindërve dhe të rrethit familjar e më gjerë. Në të shumtën e rasteve, dhuna që ushtrohet ndaj fëmijëve arsyetohet me "qëllim edukimi". Sipas këtij botëkuptimi, fëmija rrihet për t'u bërë i edukuar. Këto gabime, për fat të keq,

³ Tirmidhiu, "Birr", 33.

kanë zënë vend edhe në shumë thënie popullore si “Dajaku ka dalë nga Xhenneti”, “Aty ku të bie mësuesi mbin lule” etj. Njerëzit në të shumtën e herëve nuk e pranojnë se ushtrojnë dhunë... Sepse ata kanë një arsye “legjitime” për këtë: Ata me këtë kinse i edukojnë fëmijët e tyre! Mirëpo në qoftë se pakëz mendojmë për shkaqet dhe pasojat e veprimeve tona dhe pa e lënë pas dore peshoren e drejtësisë, para nesh do të shfaqet haptas kjo tablo: dhuna në fakt është pasojë e zemërimit tonë, e lakmisë sonë, e ngutjes sonë, e mosnjohjes së botës shpirtërore të fëmijës sonë si dhe, përfundimisht, e paaftësisë dhe e mossuksesit tonë në krijimin e një komunikimi të drejtë e të shëndoshë me ta.

Dhuna mund të përkufizohet nga pikëvështrime të ndryshme. Ne do ta japim përkufizimin e shënuar në fjalorin e Institutit të Gjuhës Turke: *“Përdorimi i forcës së ashpër, në vend*



të bindjes e të gjetjes së pajtueshmërisë, kundrejt atyre që kanë mendim ndryshe nga ne.” (Ndërsa në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe dhuna nënkupton „ushtrimin e forcës a shtrëngimin me mjete e me mënyra të vrazhda ndaj dikujt; detyrim a shtypje me anë të forcës“. – R. N.)

Në qoftë se shikojmë më me kujdes, dhe ashtu siç do të shohim edhe në pjesët e ardhshme të kësaj broshure, do të vërejmë se ka disa lloje të dhunës, edhe pse në radhë të parë ne me këtë nënkuptojmë dajakun. Prandaj, edhe pse ne fillimisht me dëshira dhe

ëndrra të mëdha e pritnim ardhjen në këtë botë të fëmijëve tanë, ata, për fat të keq, kohë pas kohe u nënshtrohen formave të ndryshme të dhunës si brenda rrethit familjar ashtu edhe jashtë tij.

I. FËMIJA SI PËRJETUES I DHUNËS


1. Dhuna fizike: rrahja, dajaku

Ashtu siç thamë edhe më parë, kur e përmendim dhunën në radhë të parë ndofta nënkuptojmë rrahjen, dajakun. Tanimë është e njohur se fëmijët i nënshtrohen dajakut sidomos për arsye edukuese. Disa prindër ndofta pendohen pas dhënies së dajakut, disa të tjerë për fat të keq besojnë se me këtë kanë bërë gjënë e duhur. Sipas tyre kjo është e nevojshme për ta edukuar fëmijën.

Në qoftë se fëmija nuk e dëgjon fjalën tonë, e meriton dajakun. Në qoftë se ka marrë notë të dobët në shkollë, në qoftë se është zënë me vëllanë ose motrën, në qoftë se ka gënjyer për diçka dhe prindi e ka zënë në flagrancë, fëmija gjithsesi, sipas tyre, e meriton dajakun. Në qoftë se fëmija i ka

shkaktuar dëm pronës së dikujt, ky gjithsesi meriton të hajë dajak. Po, kështu mendojnë disa. Ndërsa sot pranohej haptas se dajaku në asnjë farë forme nuk mund të përdoret si mjet edukimi. Po ashtu, edhe në qoftë se e shikojmë mirë e mirë jetën e Muhamedit a.s., ai kurrë nuk e ka përdorur dajakun. Ai ka qenë shumë i butë dhe i mëshirshëm ndaj çdokujt dhe çdo gjëje. Dashuria, butësia dhe mëshira e tij ndaj fëmijëve, ishte më e madhe se ndaj çdokujt tjetër. Ai është shembulli dhe modeli më i mirë për këtë, sidomos me thënien e tij të famshme: *“Nuk është prej nesh ai që nuk është i butë dhe i mëshirshëm me më të vegjlit tanë dhe ai që nuk i nderon dhe nuk i respekton më të vjetrit tanë!”*⁴

⁴ Tirmidhiu, “Birr ve’-sila”, 15.



Në Medine ishte një djalosh që quhej Rafi' bin Amër. Ai nisi vazhdimisht t'i godiste me gurë drunjtë e hurmave të një kopshti. Një ditë atë e kapi pronari i hurmave dhe e çoi te Muhammedi a.s.. I Dërguari i All-llahut e pyeti:

- O bir, pse i gjuan drunjtë e hurmës me gurë?

Rafi'u, i turpëruar dhe kokulur, tha:

- Isha i uritur, o i Dërguar i Zotit, dhe më haheshin...

Pasi e dëgjoji me kujdes djaloshin, Pejgamberi i mëshirës i tha:

- O bir, edhe një herë mos gjuaj me gurë hurmat! Mirëpo mund të

hash nga ato që kanë rënë në tokë.

Më pas Muhammedi a.s. ia përkëdheli kokën djaloshit dhe e bëri këtë du'a: *"O All-llah, ngija barkun këtij djaloshi!"*⁵

Pejgamberi ynë a.s. këtu nuk e fajësoi djaloshin, por u interesua për arsyen e këtij veprimi dhe më pas atij i ofroi një alternativë. Natyrisht që ky veprim i djaloshit nuk duhet lënë pas dore dhe kjo nuk nënkupton që të mos u përzihehi fëmijëve në sjelljet e tyre. Pejgamberi a.s. djaloshit i solli një ndalesë: të mos i gjuajë drunjtë e hurmave. Por në të njëjtën kohë i tregoi mundësinë, alternativën, i tregoi se çfarë guxonte të bënte. Ne duhet të mendojmë thellë rreth këtij shembulli dhe duhet ta krahasojmë me metodat tona të edukimit të fëmijëve. Ose le t'ia parashtrojmë vetes këtë pyetje: "Si do të veproja unë në qoftë se ndo-

⁵ Ibni Maxhe, "Tixharet", 67.



dhem para një situate të këtillë si Muhammedi a.s.?” dhe nga përgjigjja që do t’i japim vetvetes le të shikojmë se sa afër ose sa larg synimeve edukative të Pejgamberit a.s. jemi ne.

Fëmija është fëmijë dhe të vërtetat do t’i mësojë duke gabuar, duke i provuar dhe duke u mashtruar. Të sillesh me ashpërsi ndaj një fëmije të një moshe që sapo ka nisur ta njohë dhe ta mësojë jetën, tek ai mund të shkaktojë vetëm lëndim dhe përbuzje. Bile është konstatuar se edhe dënimet më të ashpra që mund t’i jepen një fëmije, pas një kohe ato bëhen “shprehi”

dhe nuk kanë më ndonjë efekt pozitiv.

Në rastin e lartpërmendur shohim se Muhammedi a.s. jo që nuk e rrahu djaloshin, por as nuk e qortoi dhe nuk e nënçmoi bile. E ç'ka të thuhet tani për ata që në emër të "edukimit" i japin vetes të drejtë për ta rrahur fëmijën e vet po edhe fëmijët e tjerë që u janë lënë amanet për t'i edukuar? Ata për këtë nuk mund të gjejnë mbështetje as edhe nga Pejgamberi a.s.

Rrahja e fëmijës, nuk ia mëson atij vetvetiu gjërat e drejta. Dënimet fizike si dajaku, shtyrja dhe qortimi ndoshta e pengojnë për një kohë sjelljen negative të fëmijës. Mirëpo ato nuk e zgjidhin problemin në rrënjë. Bile-bile fëmija ndonjëherë nuk e kupton as edhe pse ka ngrënë dajak. Ndikimi më efektiv i dajakut ndofta është humbja e vetëbesimit dhe e vetërespektimit të fëmija.

Fëmija nuk mund ta kuptojë absurditetin e dashurisë së prindërve të vet

ndaj tij dhe dajakun që ata ia japin. Te ai thyhet besimi ndaj vetvetes dhe ndaj prindërve për shkak të dajakut dhe abuzimit. Në rast se shtohet përdorimi i dajakut kjo mund të çojë deri në mospërfillje. Kohë pas kohe dëgjojmë prindër ose të tjerë të rritur për disa fëmijë të thonë: “Ky fëmijë aq i paedukatë dhe i paturpshëm që është bërë, saqë edhe dajaku s’bën pare më tek ai.” Njeriu që e thotë këtë, në fakt, nuk e ka kuptuar këtë pikë: dajaku nuk sjell asnjë dobi kur është në pyetje edukimi. Fëmija e braktis një sjellje të keqe jo pse e ka kuptuar se ajo s’është e mirë apo se nuk ia pranon më ndërgjegjja, porse vetëm për të shpëtuar nga dhimbja dhe nga lëndimi i dinjitetit që ia shkakton dajaku. Kur mësohet edhe me dajakun, atëherë as ai nuk ndikon në përmirësimin e sjelljes së tij. Prandaj, ndikimi i dajakut ka qenë me efekt të shkurter, sepse nuk i ka folur ndërgjegjes së fëmijës.



Para disa vitesh punoja si mësuese në një fshat të Anadollit. Nxënësit e parë që i kisha në këtë shkollë ishin të klasës së tretë fillore. Sa kisha dëshirë që ata të fitonin njohuri për një jetë më të mirë se kjo që e kishin, po aq dëshiroja që këta fëmijë të fitonin edhe besimin në vetveten. Një ditë, disa fëmijë që më mërzitën me sjelljet e tyre, i pyeta se pse silleshin kështu. Një nxënës tha: “Zonja mësuese, ju nuk na rrihni, prandaj edhe nuk frikohen prej jush.” Po, kjo ishte e vërteta. Fëmijët që ishin mësuar të hanin dajak, të nënçmoheshin, të përbuzeshin e të trembeshin, derisa të mësoheshin me

situatën e re, mësuesin që nuk ua bënte këto e perceptonin si të dobët. Mirëpo ata ishin fëmijë. Kishin tru dhe zemër të pastër, për ta parë dhe për ta mësuar të bukurën. Pikërisht për këtë arsye, brenda një kohe të shkurtër, ata u mësuan me sistemin e ri që unë mundohesha ta mbështetja në dashuri dhe respekt, e jo në dajak dhe përbuzje të nxënësve. U ndava që andej, nga bota e bukur e atyre fytyrave të njoma, duke e lutur Zotin që pas meje atje të shkonin mësues e mësuese që do ta vazhdonin rrugën time.

Fëmija qysh nga lindja priret drejt së mirës. Sapo të ballafaqohet me shembujt e mirë dhe të trajtohet nga të tjerët me durim, ai do t'i mësojë dhe përvetësojë shpejt sjelljet e mira e të drejta. Një baba që e gënjen shokun e vet dhe fëmijës së vet i thotë se gënjeshtër (rrëna) është një gjë shumë e keqe, nuk e ka problem ta rrahë fëmijën e vet në qoftë se ai e gënjen. Kë-

tu vërejmë shumë sjellje të gabuara. Njëra prej tyre është të jesh shembull dhe model i keq për fëmijët. Kur të mungojë shëmbëlltyra e mirë, asnjë këshillë e mësim nuk bën dobi. Gabimi i dytë këtu natyrisht se është dajaku ndaj fëmijës.

Fëmija që ha dajak vazhdimisht, brenda kohës ai do ta humbë vetëbesimin, do të mbyllet në vetvete, do të përjetojë probleme psikologjike, mirëpo ai edhe do të fillojë të ushtrojë dhunë mbi fëmijët e tjerë përreth vetes. Në shtëpi do të ushtrojë dhunë mbi vëllezërit e motrat, në shkollë mbi shokët e vet, ndoshta kur të rritet edhe mbi mësuesin ose mësuesen e vet, pse jo edhe mbi prindërit e vet... Shumica e fëmijëve që ushtrojnë dhunë, janë në fakt ata që edhe vetë kanë përjetuar dhunë në rrethin familjar. Kjo është kështu ngase dhuna mësohet duke parë dhe duke e përjetuar vetë. Fëmija, në këtë formë, kur të zemërohet, kur nuk i plotësohen dëshir-

rat, kur nuk i shkojnë punët si do ai, mëson se mund të ushtrojë dhunë mbi atë që e ka përballë dhe në fund edhe ushtron dhunë. Në këtë formë, mund të themi se, dhuna përcillet nga brezi në brez.

Dajaku „nuk ka dalë nga Xhenneti”. Edhe sikur të ketë dalë prej aty, me siguri nuk ka dalë me vetë dëshirë, mund të themi pak si me ironi. Në vend që të presim ndihmë nga dajaku, le ta zhvillojmë vetveten edhe pak më shumë. Le të mendojmë pak më shumë rreth asaj se në çfarë shtate si duhet të sillemi me fëmijët tanë. Në qoftë se nuk mund t’u bëjmë ballë situatave të vështira me të cilat ndeshemi, atëherë le të kërkojmë ndihmë dhe mbështetje nga të tjerët, në veçanti nga ekspertët. Le të jemi më të durueshëm, më tolerantë. Le të mos harrojmë se edhe ne dikur kemi qenë fëmijë. Le të kujtojmë se në cilat situata çka kemi ndier, për çka jemi gëzuar e për çka jemi dëshpëruar, le

t'i kujtojmë kohërat kur e kemi pasur vështirë t'i kuptojmë të rriturit, le t'i kujtojmë edhe dëshirat e zjarrita, ambiciet dhe ëndrrat tona si fëmijë që i kemi pasur. Le të përpiqemi ta kujtojmë se si kanë përfunduar fjalitë tona të dikurshme që fillonin me: "kur do të bëhem nënë..." ose "kur do të bëhem baba...". Le ta zgjojmë fëmijën që e kemi në brendinë tonë. Me fëmijët le të bëhemi fëmijë. Le të përpiqemi ta kuptojmë botën e ndjenjave të fëmijës.

Do të gabojmë në qoftë se themi "Unë kur isha fëmijë e kam mësuar të drejtën duke gabuar, ndërkaq sot unë e di se çfarë është e drejtë dhe e saktë, prandaj edhe nuk dua që fëmija im të gabojë." (Kur ta lexoni këtë fjali dhe të thoni: "a thuhet more një gjë e këti-llë...", para se të mendoni se me këtë jeni në një pozitë të mirë, ju këshillojmë ta mendoni më mirë se sa po e zbatoni këtë.) Sepse në të shumtën e herëve fëmijët mësojnë duke gabuar.

Sjellja dhe qëndrimi i drejtë i prindërve karshi gabimeve më të vogla të fëmijës, do të mund ta pengojë atë të mos bëjë gabime më të mëdha. Besoj se këtu duhet ta rikujtojmë metodën edukuese të Muhammedit a.s. që e përmendëm më lart: fillimisht ta analizojmë arsyen e sjelljes, pastaj t'i vendosim kufizimet dhe ndalesat e nevojshme për edukimin e fëmijës dhe krejt në fund fëmijës t'i ofrojmë alternativë, mundësi tjetër veprimi a sjelljeje.

Le të mos harrojmë se për dajakun nuk ka asnjë arsye apo sebeb. Ndonjëherë prindërit mbështeten pas justifikimit (shfajësimit): "Aq shumë nervozohem sa s'e kontrolloj dot veten, prandaj edhe i mëshoj fëmijës!" Unë dua t'i pyes këta prindër: Në qoftë se, ai që ju nervozon dhe ju nxjerr jashtë kontrollit, nuk është fëmija juaj që me shtatin e tij ju vjen deri te beli, porse të jetë një njeri i rritur dhe trupmadh, a do ta humbnit kontrollin

dhe t'ia mëshonit edhe atij? Duhet ta dimë se dajaku nuk është pasojë e gabimit të fëmijës, porse e dobësisë, e pamjaftueshmërisë dhe e mungesës së durimit që e kemi ne të rriturit. Kur nuk gjejmë fuqi për ta zgjidhur problemin, atëherë e bëjmë atë që na vjen ndoresh: e përdorim dajakun. Mirëpo këtë e bëjmë duke harruar se fëmijët i kemi amanet nga All-llahu xh.sh. dhe duke harruar se çfarë pasojash mund të lërë pas vete dajaku, shuplaka...

2. Dhuna emocionale

Dhuna emocionale nënkupton presionin psikologjik që ushtrohet mbi fëmijën në formë të qortimit, frikësimit, kërcënimit, talljes etj.

Ndofta një prej shkaqeve kryesore të dhunës ndaj fëmijëve është mendimi i prindërve se kinse ata janë pronarë të fëmijëve të tyre. Ata fëmijët e tyre i shohin si objekte (gjësende), që

mund t'i kenë në dorë dhe të sillen me ta si të duan. Ndërkaq e vërteta është se fëmijët janë amanet nga Zoti. Detyra e prindërve ose e kujdestarëve dhe e edukatorëve është që këtë amanet ta rrisin dhe ta edukojnë në mënyrë të shëndoshë fizike dhe shpirtërore, si individë të dobishëm për vetveten dhe për shoqërinë.

Më lart përmendëm se dhuna nuk është e kufizuar vetëm me dajakun. Ka shumë lloje të dhunës që lënë gjurmë të thella në shpirtin e fëmijës dhe që ndikojnë negativisht në zhvillimin e tij. Prandaj, nuk mund të themi se “fëmija që nuk ha dajak, nuk i është ekspozuar dhunës”.

Një nënë nuk është e vetëdijshme se çfarë ndikimesh negative mund të shkaktojë te fëmija i saj kur ajo e kanos me fjalët “Në qoftë se nuk e bën këtë që të them unë, nuk do të të dua më!” ose “... nuk do të jem më nëna jote!”. Ndoshta, kur ajo e sheh fëmijën e vet se pas këtij kërcënimi menjëherë



e bën atë që i tha kjo, mund të mendojë se sa mirë veprova dhe të gëzohet me këtë gjë. Mirëpo, në qoftë se mendojmë pak më thellë rreth asaj se çfarë frike shkakton te fëmija ndjenja “të mos duhesh dhe të braktisesh nga nëna”, besoj se do ta kuptojmë më qartë se, në fakt, kjo sa sjellje e shëmtuar që është nga ana e nënës.

Ta fajësosh, ta qortosh dhe ta damkosësh fëmijën me fjalën “Ti je kështu e ashtu...”, është shumë e lehtë. Prandaj edhe shumë njerëz e bëjnë këtë. Sido mos ndaj fëmijëve që janë më të pafuqishëm dhe më të varur prej të rriturve, kjo është akoma më kollaj. Qartë, kjo s’është aspak e drejtë. Në këtë

pikë ne kemi nevojë që ta kuptojmë më mirë dhe ta marrim për shembull Muhammedin a.s. Kur ta arrijmë këtë, ashtu si në çdo sferë të jetës sonë, edhe në sferën e komunikimit me fëmijët tanë do të ketë ndryshime pozitive. Atëherë, le ta dëgjojmë se çfarë na rrëfen Enesi r.a.:

“Kam jetuar në shtëpi të Muhammedit a.s. dhjetë vjet me radhë. Asnjëherë nuk më ka thënë as ‘of’ bile. Asnjëherë nuk më ka thënë: ‘Pse e bërë ashtu? Pse nuk e bërë kështu?’ Asnjëherë nuk më ka qortuar për atë që kam bërë. Nga aspekti moral ai ishte më i miri njeri. Një ditë më tha të shkoja diku. Unë i thash: ‘Pashë Zotin, nuk shkoj!’. Mirëpo nga brenda zemra më thoshte të shkoja atje ku më tha Muhammedi a.s. Kur dola përjashta i pashë disa fëmijë tek luanin. Iu afrova atyre dhe u hutova duke luajtur me ta. Kur papritmas Muhammedi a.s. më kapi pas qafe. E shikova, ndërsa ai me buzëqeshje më tha: ‘Enesi im, a

shkove ku të thash?’ Unë: ‘Po! Ja tek po shkoj tani, o i Dërguar i Zotit!’ i thashë dhe shkova.”⁶


Këtu shohim që Muhammedi a.s. e shihte si krejtësisht normale që fëmijët ndonjëherë të silleshin „si fëmijë“ dhe tregonte mirëkuptim dhe tolerancë ndaj tyre. Nuk bëhet fjalë për asnjë lloj qortimi, kërcënimi, nënçmimi apo fjalë dhe sjellje që shprehin zemërim, si për shembull: 'Çfarë fëmije je ti? Të dërgova para kaq kohe!' Nuk duhet të biem në gabimin e të menduarit se kjo sjellje është një mrekulli profetike dhe të harrojmë që peygamberët janë shembull për ne. Sjellja e tyre ka për qëllim që, ata që i ndjekin, t'i imitojnë ata me sjellje të ngjashme në situata të ngjashme. Sjelljet e tyre nuk janë për t'u vlerësuar si të paprekshme apo të paarritshme.

⁶ Muslimi, “Fedail”, 51, 53, 54.

Në përfundim, edhe ne duhet të mos harrojmë se fëmijët janë fëmijë, ata mësojnë duke provuar dhe gabuar, dhe se është krejt normale që ndonjëherë të jenë të padisiplinuar. Edhe nëse nuk e miratojmë sjelljen, duhet të tregojmë mirëkuptim ndaj fëmijës. Duhet të jemi të mëshirshëm ndaj fëmijëve.

Mund të ketë njerëz që mendojnë se shfaqja e mëshirës dhe e tolerancës ndaj fëmijëve mund t'i lazdrojë ata. Nëse toleranca nënkupton mungesë të plotë të rregullave, atëherë ky mendim është i drejtë. Sigurisht, toleranca e pakufizuar do të çojë në lazdrim dhe do ta pengojë fëmijën që t'i mësojë vlerat, rregullat e jetesës në shoqëri dhe të bëhet një individ me përgjegjësi. Në këtë pikë, është e dobishme të kujtojmë shembullin që dhamë në fillim të diskutimit tonë, kur Profeti ynë i Shenjtë tregoi një qëndrim të tolerueshëm ndaj fëmijës që goditi me gur pemën e hurmave,

por më pas e ndaloi atë nga goditja e pemës dhe i ofroi një alternativë, ashtu siç edhe na rekomandon sot shkenca e pedagogjisë.



Tallja dhe vënia e nofkave fyese janë gjithashtu forma të dhunës që dëmtojnë fëmijën. Fjalët si: "Je budalla me brirë!", "I paaftë!", "A do të bësh ndonjë punë si duhet ndonjëherë?", "Çfarë tjetër bën ti përveçse të më mërzi-tësh?", janë fjalë fajësuese dhe nënçmuese që e bëjnë fëmijën të ndihet i pavlerë. Një fëmijë që dëgjon vazhdi-

misht të tilla fjalë do të fillojë, me kalin e kohës, të besojë se janë të vërteta dhe do ta perceptojë vetveten ashtu siç i thuhet. Prindërit nuk mendojnë me të vërtetë se fëmijët e tyre janë budallenj; ndoshta e kanë thënë në çast zemërimi, por fëmija nuk është në gjendje ta kuptojë këtë. Ai i jep shumë rëndësi asaj që i thuhet, veçanërisht nga prindërit e tij, dhe beson se ato janë të vërteta. Si rezultat, fëmija fillon ta pranojë e ta njohë veten si të tillë, sepse në sytë e tij, prindërit janë dritarja e tij në botë dhe e shohin veten ashtu siç ata e përshkruajnë.

Si rezultat, fëmija fillon ta pranojë e ta njohë vetveten ashtu siç ia kanë imponuar prindërit, sepse për të, prindërit janë ata që e lidhin me jetën dhe i thonë se ai është "një fëmijë i keq", "i padisiplinuar" ose "budalla". Kur fëmijët fillojnë të besojnë se janë të tillë, ata ndihen sikur nuk kanë më asgjë për të humbur. Për pasojë, komunikimi i tyre me familjen bëhet

gjithnjë e më problematik me kalimin e kohës. Të tillë fëmijë kemi mjaft në rrethin tonë shoqëror.

Mund të na vijë në mendje një pyetje si kjo: "Ne jemi gjithashtu njerëz, punojmë gjithë ditën, lodhemi, ndonjëherë përballemi me situata stresuese, jeta nuk është një kopsht trëndafilash pa gjemba!.. Nuk mund të jemi gjithmonë të gëzuar dhe të durueshëm. A nuk ka momente kur njeriu zemërohet, e sheh gabim atë që bën fëmija dhe reagon me nervozizëm?"

Këto janë sigurisht të vërteta, por ajo që është e gabuar është kjo: Shprehja e zemërimit përmes dhunës, të bërtitave, fyerjeve dhe krijimit të një atmosfere terrori në shtëpi. Një nënë ose baba mund të jenë të lodhur, të tensionuar dhe nervoz për shkak të situatave negative që kanë përjetuar gjatë ditës. Për më tepër, diçka që bëjnë fëmijët mund t'i zemërojë edhe më shumë. Në një situatë të tillë, gjëja më e duhur që mund të bëhet nuk është

të krijohet një atmosferë terrori në shtëpi, por t'i shpjegohet fëmijës se çfarë ndikimi ka sjellja e tij tek ne.

Për shembull, nëse një nënë kthehet në shtëpi pas një dite të lodhshme dhe sheh se shtëpia është rrëmujë, dhe pastaj u thotë fëmijëve: "Jam lodhur nga kjo rrëmujë e juaja. Prapë e keni bërë gjithë shtëpinë rrëmujë! Unë a shërbëtore jam në këtë shtëpi? A gjithmonë unë do ta ndreqi rrëmujën që bëni ju? Sa të rrëmujujshëm që jeni!", ajo do të vërejë se fëmijët e saj nuk e marrin parasysh gjuhën që ajo u drejtohet me „ju“, dhe mund edhe të habitet, po madje edhe të nervozohet edhe më shumë nga kjo situatë. Ndërkaj, nëse në vend të kësaj, ajo u shpjegon atyre se si ndihet kur e sheh shtëpinë në atë gjendje pas një dite të stërlodhshme, do të ishte më efektive. Nëse ajo thotë: "Kam qenë e lodhur gjatë gjithë ditës. Kur erdha, prisja të shihja një shtëpi të rregullt. Kur i pashë të gjitha të çrregulluara, u

ndjeva e mërzhitur; për këtë arsye jam nervoze", ajo do t'u tregojë qartë fëmijëve të saj se si ndihet, dhe duke mos i fajësuar fëmijët e saj për situatën, ajo do të krijojë një komunikim më të mirë me ta. Le ta vendosim veten në vendin e fëmijëve. Kur dikush na urdhëron me zë të lartë të bëjmë diçka, ne ndihemi të irrituar. Fëmijët gjithashtu, ashtu si të rriturit, më shumë preferojnë të veprojnë sipas dëshirave dhe vendimeve të tyre sesa sipas asaj që u thuhet të bëjnë. Kur një nënë thotë: "Më bën të ndjem e palumtur dhe e irrituar të jetoj në një shtëpi të rrëmuishme", ajo me këtë nuk jep urdhër. Nëse ajo është e qetë dhe e duruar, fëmija, pasi të kuptojë se çfarë ndien nëna e tij, pas një kohe do të fillojë vetë t'i rregullojë gjërat. Në këtë mënyrë, fëmija, duke besuar në nevojën e mbajtjes së shtëpisë të rregullt, do ta bëjë këtë me vendimin që e merr vetë për këtë.

Një mënyrë tjetër për të mos i lënduar të tjerët kur jemi shumë të zemëruar, është të mos flasim.

*"Nëse dikush është i zemëruar ndërsa qëndron në këmbë, le të ulet menjëherë. Nëse zemërimi i largohet (mirë), por nëse nuk i largohet, atëherë le të shtrihet."*⁷

Këto këshilla të Pejgamberit tonë të dashur natyrisht që nuk janë vetëm për të rriturit. Fëmijët, që janë amanet në duart tona, e meritojnë këtë durim, dashuri dhe trajtim të mirë më shumë se kushdo tjetër.

Të mbyllësh një fëmijë në banjë, tualet apo në një vend të errët është një praktikë që përfshin dhunë. Të përpiqesh të edukosh një fëmijë në këtë mënyrë - nëse qëllimi është vërtet edukimi - kjo është një sjellje që e humbet qëllimin e saj. Për më tepër, kjo mund të shkaktojë që fëmija të përjetojë frikë të madhe dhe të zhvi-

⁷ Ahmed bin Hanbeli, Musned, V, 152.

llojë frikëra të tjera të ndryshme. Sa i përket arritjes së qëllimit të korigjimit të sjelljes së gabuar, atë që kemi thënë për rrahjen, vlen edhe për këtë situatë. Pra, mbyllja e fëmijës në një vend, nuk do të ndihmojë që ai ta kuptojë dhe ta korigjojë gabimin e tij. Ndoshta, për një kohë, ai do të heqë dorë nga sjellja e tij për të mos u ndëshkuar përsëri. Nëse fëmija mësohet me mbylljen, ai mund të vazhdojë me të njëjtën sjellje duke e marrë parasysh ndëshkimin ose madje mund të shkojë edhe më larg. Në këtë rast, është e qartë se puna e prindërve do të bëhet edhe më e vështirë.

Në komunikimin me fëmijët tanë, mbështetja në mëshirë do të sjellë rezultate më të mira, si për shëndetin e tyre fizik dhe mendor, ashtu edhe për zhvillimin dhe edukimin e tyre. Pejgamberi ynë a.s., i cili është një shembull i përkryer për mëshirën ndaj fëmijëve, kur e kishte në prehrin e tij Usame bin Zejdin dhe nipin e tij Hasa-

nin, i lutej Zotit kështu: "O Zot! Ji i mëshirshëm ndaj tyre, sepse unë i mëshiroj ata." ⁸

Për të pasur fëmijë të shëndetshëm fizikisht dhe të lumtur shpirtërisht, dhe, për pasojë, për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie të përbërë nga individë të shëndetshëm dhe të mirëedukuar, ne duhet t'i mbrojmë fëmijët tanë nga çdo formë dhune. Natyrisht, duke filluar me dhunën që e ushtrojmë ne, qoftë në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme. Për këtë, është e nevojshme të jemi të vetëdijshëm për llojet e sjelljeve që përfshijnë dhunë. Duke marrë parasysh shembujt e dhunës emocionale të radhitura më poshtë, të asaj që mund të quhet "abuzim emocional", ju mund të përcaktoni nëse keni ndonjë prirje ndaj këtij lloji dhune. Madje edhe ju mund të krijoni një listë të tillë për sjelljet tuaja. Kur bëhemi të ve-

⁸ Buhariu, "Edeb", 22.



të diershëm për një problem dhe e pranojmë atë si gabim, hapi i parë drejt zgjidhjes tashmë është ndërmarrë. Pas kësaj, çështja kërkon vetëm pak përpjekje, kujdes dhe vëmendje.

3. Shembuj të dhunës emocionale:

Nëna ose babai i bërtet fëmijës, nga arsyeja se bashkëshorti/ja nuk i kryen përgjegjësitë e veta.

Kritika e vazhdueshme e bashkëshortit/es përpara fëmijëve.

Ankimi i prindit te fëmijët për bashkëshortin/en e vet.

Përzgjedhja e fëmijëve si shokë për t'u rrëfyer brengat dhe hallet.

Ose këto fjalë që mund t'u thuhën fëmijëve:

"E shihni se babai juaj më trajton keq dhe po na bën padrejtësi të gjithëve. Po të mos ishit ju, nuk do ta duroja këtë burrë as një ditë. Të paktën ju mos më shqetësoni!"

"Një ditë do të më bëni të vdes nga mërzia."

"Vdeksha dhe babai juaj e marrtë një nënë të re për ju! Atëherë do të më kërkon, por nuk do të më gjeni."

"Po e bëj jetën time kurban për ju. Çfarë nuk po heq për ju. Çfarë do të më thoni për këtë që po bëni?"

"Nëse nuk e bën atë që them, nuk do të të dua më dhe do të bëhem nëna e një fëmije tjetër."

"Shikoje vajzën e zonjës Fatma; sa e edukuar që është, mashallah! I admiroj fëmijët e tjerë kur i shikoj."

"Gjithë ditën po e duroj erën e keqe të gojës së turlifarë njeriu, vetëm e vetëm që ju të shkolloheni e të bëheni dikushi."

"Këto para që kam shpenzuar për kursin tënd privat, do të kishin mjaftuar për ta nisur një biznes. Ti duhet të mësosh dhe të arrish sukses!"

"Çfarë fëmije i pa marrë vesh që je ti?!"

"Shiko, a bën vëllai yt si ti? Sa të zgjuar që e kam djalin tim! Ah, sikur të ishe gjysmë aq i zgjuar sa vëllai yt..."

Çdo lloj gjykimi dhe akuzimi negativ përmban abuzim emocional. Cilësimet si: "Ti je një dembel!", "budalla", "frikacak", "i pavlerë", "i ngathët", janë shembuj të abuzimit emocional.

Këtë diskutim për dhunën emocionale dua ta përfundoj me një citat që më pëlqen shumë:

„FËMIJËT E MËSOJNË ATË QË E (PËR)JETOJNË “

Nëse fëmijët jetojnë me kritika, ata mësojnë të fajësojnë.

Nëse fëmijët jetojnë me armiqësi, ata mësojnë të zihen.

Nëse fëmijët jetojnë me tallje, ata mësojnë të jenë të turpshëm.

Nëse fëmijët jetojnë me turp, ata mësojnë të ndihen fajtorë.

Nëse fëmijët jetojnë me inkurajim, ata e mësojnë vetëbesimin.

Nëse fëmijët jetojnë me tolerancë, ata mësojnë të jenë të durueshëm.

Nëse fëmijët jetojnë me lavdërime, ata mësojnë të vlerësojnë.

Nëse fëmijët jetojnë me pranueshmëri, ata mësojnë të duan.

Nëse fëmijët jetojnë me miratim, ata mësojnë ta pëlqejnë veten e tyre.

Nëse fëmijët jetojnë me ndershmëri, ata mësojnë të jenë të sinqertë.

Nëse fëmijët jetojnë me siguri, ata mësojnë të kenë besim te vetja dhe te të tjerët.

Nëse fëmijët jetojnë me miqësi, ata mësojnë se bota është një vend i mirë për të jetuar.⁹

4. Fëmijët nën kthetrat e reklamave dhe mania e konsumit

Ndër format e dhunës që fëmijët përjetojnë drejtpërdrejt, desha të trajtoja veçanërisht dhunën e reklamave që vjen si një lumë i pandalshëm nga mediat. Këtu këtë çështje nuk do ta shqyrtoj nga këndvështrimi i elementeve të dhunës fizike që përmban ajo. Prandaj vendosa ta trajtoj në këtë pjesë, e jo nën titullin "Ekspozimi i fëmijës ndaj pamjeve të dhunës në media", që do të vijë më poshtë. Sepse lloji i dhunës që do të shpjegojmë së

⁹ Dorothy Law Nolte, *Children Learn What They Live*.

shpejti ka të bëjë me perceptimin e fëmijëve si subjekte të konsumit.



Me një slogan si "Jeta është këtu", një pamje që i bën thirrje vazhdimisht fëmijës nga ekrani me mesazhin "Nëse nuk e blen këtë, nëse nuk e konsumon këtë, do të ketë një mungesë të rëndësishme në jetën tënde!" ose "Kur ta përdorësh këtë produkt, jeta jote do të bëhet më kuptimplotë dhe më e bukur!", mund të perceptohet nga fëmija si diçka që patjetër duhet ta zotërojë. Ky mashtrim mund të ndodhë edhe tek të rriturit. Në fakt,

shumë produkte konsumi që nuk janë të nevojshme, do të prezantohen në reklama si nevoja të mëdha, dhe për një fëmijë që nuk e ka të zhvilluar plotësisht aftësinë për të dalluar të drejtën nga e gabuara, ose nevojën nga luksi, kjo situatë mund të shndërrohet në një ndjenjë mungese që mund të mbushet me ndjenja inferioriteti dhe mllefi të fëmija. Gjithashtu, fëmija mund të hyjë në konflikt me prindërit e tij që nuk duan t'i bëjnë këto shpenzime.

Duke marrë parasysh numrin e madh të produkteve që reklamohen, mund të shihet më qartë se sa i madh është ky bombardim me reklama.

Një nga dëmet më të mëdha të reklamave për fëmijët është që i bën ata të mendojnë se zotërimi i pasurisë dhe konsumi janë qëllimi i vetëm në jetë. Si rezultat i kësaj, pashmangshëm do të zhvillohet një profil njeriu i tillë për të cilin dëshirat dhe nevojat nuk kanë fund, i cili bëhet egoist në për-

pjekjen për të marrë gjërat që beson se i duhen, i cili nuk i merr në konsideratë ata që janë në pozitë më të ulët se ai apo që kanë nevoja, dhe i cili më shumë rëndësi i jep „zotërimit“ sesa çdo gjëje tjetër.

Një tjetër problem është se reklamat e produkteve që nuk janë të destinuara për fëmijë, shpesh ua drejtojnë mesazhet e tyre fëmijëve. Për shembull, në një reklamë të një makine që normalisht do t'i drejtohej babait, mund të shfaqet mesazhi: "Fëmijë, kjo është makina që u përshtatet juve dhe babait tuaj. Bindeni babain tuaj ta blejë këtë makinë." Gjithashtu, në reklamë mund të përdoren edhe aktorë fëmijë. Po ashtu, në një reklamë për bizhuteri, babai mund të përpiqet të bindet për të blerë një stoli përmes ndërmjetësimit të fëmijës. Kështu, në familjen moderne, "princat dhe princeshat e vogla", që qëndrojnë në "këndin kryesor" të shtëpisë, për të cilët plotësohen dëshirat materiale

me qëllim që të bëhen të lumtur, por që nuk mund të bëhen të lumtur pa varësisht përpjekjeve të familjes, shërbejnë si një mjet për të bindur prindërit dhe për të rritur shitjet e produkteve. Reklamuesit duket se e kanë vërejtur këtë situatë kundërtë-nëse në familjet moderne dhe po përfitojnë prej saj.

Mund të përmendim disa masa që familjet mund t'i ndërmarrin për t'i mbrojtur fëmijët e tyre nga kjo dhunë:

- Nuk duhet t'u lejojmë fëmijëve të shohin reklamat, vetëm nga arsyeja se ato e tërheqin vëmendjen e tyre dhe i argëtojnë ata.

- Edhe nëse përpjekimi maksimalisht, nuk duket se është realiste t'u ndalojmë plotësisht fëmijëve që të shohin reklama. Prandaj, ne duhet t'i informojmë fëmijët tanë për reklamat që shohin. Duhet t'u shpjegojmë atyre që, çdo gjë që e shohin dhe e dëgjojnë në reklama, të mos e marrin si të vër-

tetë të pandryshueshme. Duhet t'i mësojmë ta kontrollojnë impulsin e blerjes, t'u ndihmojmë që nevojat e tyre t'i përcaktojnë në mënyrë realiste duke u dhënë shembull, t'i nxisim të mendojnë përse i blejnë gjërat që i blejnë, si dhe të diskutojmë me ta për ngjarjet dhe dukuritë që shfaqen në reklama. Kjo sepse reklammat, përveç disa informacioneve të përgjithshme, përmbajnë edhe informacione që reklamuesi dëshiron ne t'u besojmë. Shikuesit, përveç këtyre informacioneve të përgjithshme, priren t'i pranojnë edhe informacionet e tjera si të vërteta. Tek fëmijët kjo ndodh më shpesh, pra ata binden më lehtë.

Procesi i blerjes mund të bëhet një shembull i mirë për fëmijët duke mos marrë vendime të nxituara, por duke e shtrirë atë në kohë dhe duke e realizuar vetëm pasi të jenë përcaktuar saktë dhe në mënyrë realiste nevojat që kemi.

II. FËMIJA SI DËSHMITAR I DHUNËS

1. Fëmija, dëshmitar i dhunës në shtëpi

Kur një fëmijë është dëshmitar i dhunës që i ushtrohet ndonjë anëtar i familjes, ai përjeton më së paku aq dëm sa do të kishte përjetuar edhe vetë ai, nëse dhuna do të ishte ushtruar mbi të. Konfliktet mes prindërve ose dhuna që njëri prind e ushtron mbi tjetrin, e shqetësojnë fëmijën tej mase, ngase ai pret prej tyre që ata t'i ofrojnë atij një rreth të sigurt familjar. Fëmija mund të frikësohet se prindërit do të ndahen ose se do ta humbasë njërin prej tyre, madje ai mund të përjetojë edhe frikëra të tjera.

Një fëmijë që rritet duke qenë dëshmitar i dhunës, e mëson edhe vetë

dhunën. Ndonjëherë ai fillon të ush-
trojë dhunë, duke e konsideruar atë
si një reagim të natyrshëm. Pra, dhu-
na që ka parë, mund ta bëjë atë ose
më të izoluar e më të mbyllur në vet-
vete, ose më të prirur për të qenë ag-
resiv dhe i dhunshëm.



Është një fatkeqësi e madhe për fëmi-
jët dhe të rinjtë që jetojnë në një shtë-
pi ku njëri prind përherë e poshtëron,
e ofendon, e prek në sedër, e kritikon
vazhdimisht dhe përdor fjalë nën-
çmuese ndaj prindit tjetër. Në këto fa-
milje, fëmijët janë gjithmonë në një

gjendje të vazhdueshme tensioni. Ata mund të jenë vazhdimisht të shqetësuar duke menduar: "Çfarë do të kritikojë tani babai?" ose "Çfarë veprimi të babait nuk do të pëlqejë nëna dhe do të fillojë të bërtasë?" Ekspozimi i fëmijës ndaj kësaj gjendjeje të vazhdueshme tensioni dhe stresi është padyshim një lloj dhune. Prandaj, është shumë e rëndësishme që bashkëshortët ta duan dhe ta respektojnë njëri-tjetrin, të kultivojnë marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin, sepse kjo është e nevojshme jo vetëm për lumturinë e tyre dhe për vazhdimësinë e familjes, por edhe për t'u siguruar që fëmijët e tyre, që janë drita e syve të tyre, të rriten si individë të lumtur dhe të shëndetshëm.

2. Fëmija, dëshmitar i pamjeve të dhunës në media

Media është një fjalë me një kuptim shumë të gjerë... Ky koncept përfshin mjete të ndryshme të komunikimit masiv si radion, televizionin, gazetën, internetin etj. Në ditët e sotme, mediat të cilave fëmijët dhe të rinjtë u ekspozohen dhe i konsumojnë më shumë janë televizioni dhe interneti.

Televizioni është bërë pothuajse "miku elektronik" i familjes. Edhe nëse nuk e shikojmë, shpesh e mbajmë të ndezur. Kështu, fëmijët në shtëpi gjithashtu shikojnë televizorin që është vazhdimisht i ndezur.

Edhe nëse nuk ka asnjë skenë dhune, kërkimet e shumta kanë treguar se shikimi i tepërt i televizionit është i dëmshëm për zhvillimin e fëmijës. Kur mendojmë se në pothuajse çdo lloj programi televiziv ka skena të ndryshme dhune, kuptojmë se përballimi me një tablo edhe më të zyrtë. Elementi i dhunës mund të gjendet

në shumë programe, që nga filmat vizatimorë për fëmijë, e deri te serialet televizive, filmat, programet e lajmeve dhe ato të showbiz-it. Edhe nëse fëmija nuk ulet për ta parë drejtpërdrejt, ai qëndron pranë televizorit të ndezur dhe ekspozohet ndaj kësaj dhune.

Sipas rezultateve të një studimi të kryer nga Instituti për Kërkime Familjare në vitin 1994:



"Fëmijët në familjet turke shikojnë mesatarisht tre orë televizion në ditë. Duke marrë parasysh që gjatë fundjavës shikojnë edhe më shumë, mund të themi se çdo tri orë të kaluara zgju-

ar, njëra prej tyre shpenzohet duke parë televizion. Në kanalet televizive turke, thuajse në çdo lloj programi, dhuna dhe krimi theksohen shumë. Gjithashtu, ka edhe përmbajtje seksuale verbale dhe fizike. Të rriturit as nuk ndërhyjnë në shikimin e televizorit nga ana e fëmijëve dhe as nuk i orientojnë ata. Ata nuk diskutojnë me fëmijët për atë që po shikojnë. Fëmijët jo vetëm që shikojnë shumë televizion, por edhe normat e shikimit në mbrëmje dhe natë janë të larta." ¹⁰

Në këtë situatë, fëmijët janë shumë të ekspozuar ndaj çdo lloj materiali që transmetohet në televizion, siç e përmendëm më lart.

Prandaj, pyetja e rëndësishme që kemi përpara është kjo: Çfarë ndikimesh ka ekspozimi ndaj imazheve të dhunës tek fëmijët?

¹⁰ Veysel Batmaz, Asu Aksoy, *Türkiye'de Televizyon ve Aile* (Televizioni dhe familja në Turqi), Ankara, 1995, fq. 77-80, 86.

Pika e përbashkët e shumicës së kërkimeve në këtë fushë është kjo: Fëmijët ndikohen negativisht nga imazhet që përmbajnë dhunë. Sipas disa kërkimeve të kryera mbi fëmijët në moshë shkollore, imazhet e dhunës shkaktojnë që fëmijët e qetë dhe të turpshëm të bëhen më të tërhequr dhe të zhvillojnë frikëra. Ndërsa, fëmijët e zemëruar bëhen më agresivë. Këta fëmijë mund të përpiqen ta ushtrojnë ndaj shokëve të tyre atë që shohin në televizion. Pra, çdo fëmijë ndikohet nga imazhet e dhunës në televizion në përputhje me personalitetin e tij. Nga ana tjetër, fëmijët që rriten në familje ku debatet dhe zënkat janë të zakonshme, kanë më shumë prirje për të qenë të dhunshëm dhe janë më të gatshëm të provojnë ato që shohin në televizion.¹¹

¹¹ Atalay Yörükoğlu, *Değişen Toplum'da Aile ve Çocuk* (Familja dhe fëmija në një shoqëri në ndryshim), Özgür Yay, fq. 100.



Një aspekt tjetër i rrezikshëm i ekspozimit ndaj imazheve të dhunës për fëmijët e vegjël është se deri në një moshë të caktuar, fëmijët nuk e kanë aftësinë mendore për të bërë dallimin midis fantazisë dhe realitetit. (Madje për këtë arsye, ata shpesh i tregojnë fantazitë e tyre sikur të ishin reale. Nënash shqetësohen duke menduar se fëmija i tyre po gënjen. Me-

gjithatë, nga këndvështrimi i fëmijës, situata është ndryshe. Ai po i tregon të vërtetat e tij ose fantazitë që i konsideron të vërteta.) Duke marrë parasysh që ndjenja e realitetit te një fëmijë fillon të zhvillohet në moshën shtatë vjeçare,¹² e kuptojmë se është e rëndësishme, por jo e mjaftueshme, t'u shpjegojmë fëmijëve nën këtë moshë se pamjet që shohin në televizion nuk janë të vërteta. Të lejosh një fëmijë t'i shohë këto pamje dhe më pas t'i thuash që të mos ketë frikë, duke i shpjeguar se ato nuk janë të vërteta, nuk e zgjidh problemin. Ndoshta ai do të thotë: "Edhe unë e di që nuk janë të vërteta", por në realitet nuk do të mund ta bëjë këtë dallim plotësisht. Si rezultat, ai mund të trembet, të bëhet i tërhequr në vetvete dhe të zhvillojë frikëra si gjatë natës ashtu edhe gjatë ditës.

¹² Nevzat Tarhan, *Makul Çözüm* (Zgjidhja racionale), Timaş Yay., Stamboll 2005, fq. 102.

Një tjetër efekt i ekspozimit ndaj një numri të madh të pamjeve të dhunshme është që fëmijët bëhen indiferehtë, të pandjeshëm ndaj tyre. Në një film vizatimor, një hero mund të goditet nga një makinë e madhe, të bëhet plotësisht i sheshtë në mënyrë qesharake dhe më pas të kthehet në gjendjen e tij normale për të vazhduar me aventura të tjera. Ose, në një film tjetër vizatimor, një hero mund të qëllohet nga një tjetër, por kjo vetëm shkakton një situatë qesharake dhe heroi i qëlluar vazhdon të ndjekë aventura të tjera më vonë. Është e vështirë që mendja e një fëmije të krijojë një përshtypje se ngjarjet e këti-lla do të shkaktojnë dhimbje.

Ne jetojmë në një kohë kur edhe luftërat transmetohen drejtpërdrejt në televizion. Jemi kaq të ekspozuar ndaj pamjeve të dhunshme dhe lajmeve "të këqija" sa që, ndërsa dëgjojmë ose shikojmë lajme për një aksident trafiku ku disa njerëz kanë vde-

kur e shumë të tjerë janë lënduar, apo për një akt bombardimi, mund të vazhdojmë të hamë në sofër pa u shqetësuar. Tani mendoni për fëmijët. Edhe ata po bëhen të pandjeshëm ndaj vuajtjeve të të tjerëve dhe ndaj rasteve të shumta të vrasjeve me të cilat përballen.

Fëmijët nuk shikojnë vetëm programet që janë përgatitur posaçërisht për ta, prandaj pamjet e dhunës në programet e tjera janë një çështje e rëndësishme që duhet trajtuar. Kemi dëgjuar më parë për lajme të ngjashme, përpara se të dëgjonim për një rast ku një fëmijë tentoi të imiton-te një skenë vetëvrasjeje nga programi televiziv që e kishin parë bashkë me tre-katër shokë të tjerë, duke u varur nga dritarja me një mbulesë, dhe, kur jastëku nën këmbët e tij rrëshqiti, humbi jetën. Kur shokët e tij panë që ai nuk po lëvizte për një kohë të gjatë, ata, të frikësuar, lajmëruan nënat e tyre. Këto dhe ngjarje të

ngjashme të trishtueshme mund të duken si raste të rralla, por janë shembuj që na kujtojnë në mënyrë të hidhur se fëmijët nuk mund të men- dojnë si të rriturit dhe se gjërat që i shohin dhe i dëgjojnë i perceptojnë në mënyrë të ndryshme nga ata.



Një fëmijë që luan në heshtje pranë një të rrituri që po shikon televizor mund të duket sikur është i pavëmendshëm ndaj programit dhe i përqendruar në lojën e tij. Megjithatë, nëse i bëjmë disa pyetje për temat e programit, veçanërisht për ato që përmbajnë dhunë, do të zbulojmë se

ai është plotësisht i vetëdijshëm për atë që po ndodh. Mendimi "Është fëmijë, nuk kupton" apo "Ai po luan, nuk i dëgjon apo nuk i shikon këto gjëra", është padyshim i gabuar. E vërteta është kjo: Fëmija kupton dhe ndien.

Për të parandaluar ose reduktuar ekspozimin e fëmijës ndaj pamjeve të dhunës në televizor, masa e parë që familja mund të marrë është vendosja e kufizimeve për kohën e shikimit të televizorit. Për ta realizuar këtë, gjëja e parë që prindërit duhet të bëjnë është të kufizojnë kohën e vet të shikimit të televizorit. Në një shtëpi ku televizori është i ndezur 24 orë, do të jetë e vështirë të vendosen kufizime për shikimin e televizorit nga fëmijët. Prandaj, si për veten tonë ashtu edhe për fëmijët tanë, duhet të gjejmë aktivitete të tjera për kohën e lirë, larg televizorit. Nuk do të duhet të habitemi kur të kuptojmë se kjo mund të na ndihmojë të fillojmë të ndajmë

më shumë gjëra me anëtarët e familjes dhe të kemi një komunikim më të lehtë me njëri-tjetrin.

Një program i planifikuar për shikimin e televizorit mund të na ndihmojë në këtë drejtim. Në këtë mënyrë, programet që fëmijët do të shikojnë do të jenë të përcaktuara paraprakisht.

Përkundër përpjekjeve tona, nuk do të mundemi gjithmonë t'i parandalojmë fëmijët tanë të mos u ekspozohen pamjeve të dhunës në media. Një nga mënyrat për të minimizuar efektet e kësaj situate është të shikojmë programet së bashku me ta. Gjatë shikimit të programeve, është e rëndësishme të bisedojmë me fëmijët për pamjet dhe bisedat që shfaqen, për të mësuar mendimet e tyre. Nëse ka ndonjë pamje që nuk e miratoni dhe këtë nuk ua thoni fëmijëve, porse rri- ni të heshtur, ata nuk do ta dinë se ju këtë pamje e konsideroni të gabuar. Duke qëndruar të heshtur për çdo



pamje negative që shihni, në mendjen e fëmijës suaj, tek i cili sapo ka filluar formimi i vlerave të tij morale dhe mësimi se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar, në bazë të asaj që e jeton dhe e sheh, do të krijohet përshtypja se "Nëna dhe babai e konsiderojnë këtë gjë normale, pra nuk është diçka e keqe!" Kjo nga arsyeja se fëmija nuk ka lindur duke i ditur të gjitha të vërtetat e jetës! Prandaj, sjelljet dhe fjalët që nuk i konsideroni të drejta, duhet t'ia tregoni fëmijës, duke ia shpjeguar edhe arsyet për këtë.

Fëmija lind me prirjen për të mirën dhe të drejtën, por kjo assesi nuk do të thotë se ai lind me njohuritë rreth


së mirës, së bukurës dhe së drejtës. Njohuritë dhe përvojat që për ne të rriturit janë të thjeshta e të zakonshme, fëmija do t'i mësojë ndonjëherë duke i përjetuar, ndonjëherë duke lexuar, ndonjëherë duke bërë gabime, duke eksperimentuar, duke dështuar dhe ndonjëherë duke ndier. Prandaj, mos hezitoni ta kritikoni në mënyrë të përshtatshme një padrejtësi, gabim, ose një skenë dhune në një program televiziv që po shihni, duke mos përtuar t'i tregoni fëmijës suaj se ato i konsideroni të gabuara. Nuk duhet t'ua mohojmë këtë mirësi fëmijëve tanë, vetes sonë, shoqërisë sonë dhe, në fund, botës sonë.

Por, a përfundon përgjegjësia jonë vetëm duke i kritikuar pamjet që ne na duken gabim dhe duke ia shpjeguar fëmijës se pse janë gabim? Sigurisht që jo. Nuk mund të themi se mund t'ia lejojmë fëmijës të shikojë çfarëdo programi, vetëm sepse ia kemi bërë shpjegimet e nevojshme.

Sepse, siç e përmendëm më parë, ekspozimi ndaj pamjeve të dhunshme i bën individët të pandjeshëm, duke çuar në perceptimin dhe mësimin e dhunës si diçka normale. Edhe nëse fëmijës i shpjegohet se dhuna është e gabuar, ai ende sheh se problemet mund të zgjidhen më lehtë me anë të dhunës. Ai sheh dhe e regjistron në kokë se si një burrë i zemëruar e godet gruan ose të fejuarën e tij me një shuplakë, se grupet që zihen nxjerrin menjëherë armët apo thikat që mbajnë me vete, dhe se njerëzit që debatojnë fillojnë papritmas ta godasin njëri-tjetrin me grushta e shqelma. Sidomos nëse sheh se ai që e përdor dhunën arrinë të jetë i suksesshëm, ndjenja e tij e drejtësisë mund të dëmtohet dhe, edhe pse e di se është gabim, ai mund të bëhet i prirur ta përdorë dhunën vetë.

Nuk do t'i kemi përmbushur plotësisht përgjegjësitë tona nëse nuk i shprehim reagimet tona lidhur me

programet ose pamjet që nuk i aprovojmë dhe që i konsiderojmë të dëmshme në televizion, qoftë duke i adresuar këto shqetësime ndaj kanaleve televizive ose ndaj institucioneve përkatëse.



Edhe lojërat kompjuterike ofrojnë një mjedis ku fëmijët janë të ekspozuar ndaj dhunës vizuale në mënyrë të tepruar. Në këto lojëra, të bazuara në vrasje, shkatërrim dhe plagosje, fëmijët bëhen drejtpërdrejt autorë të dhunës virtuale, ose, nëse nuk arrijnë të jenë të suksesshëm, ata vetë bëhen viktimë të dhunës virtuale. Nuk gabojmë nëse themi se aspekti më i rre-

zikshëm i këtyre lojërave është normalizimi i dhunës. A mos vallë një person që shtyp një buton dhe bombardon një qytet qindra kilometra larg ndihet si një hero që ka fituar një lojë? Ushtarët e rinj që i fotografojnë njerëzit që janë duke i torturuar në vendet e pushtuara, a thua thjesht janë duke e dokumentuar "fitoren" e tyre në një "lojë"? Fëmijët që e rrahin një bashkëmoshatar të tyre në oborrin e shkollës a mund ta kuptojnë se atij po i shkaktojnë dhimbje dhe se kjo dhunë mund të ketë pasoja serioze për të? Me shumë gjasë, ata mendojnë vetëm për të dalë fitimtarë. Në lojërat kompjuterike është po njësoj; synohet vetëm rezultati final. Në këto lojëra, nuk ka shumë kohë për t'u menduar; kush sulmon më shpejt, fiton. Sepse, kur kalojnë në një lojë tjetër, heroi virtual që vdiq në lojën e mëparshme shfaqet sërish përballë tyre, në gjendjen e tij të mëparshme. Kush mund të garantojë që shprehitë e fituara në këto lojëra nuk do të

vazhdojnë në jetën reale? Ka shumë kërkime dhe statistika mbi këto çështje, por nuk duam të flasim për to këtu. Thjesht le të ndalemi për një moment dhe të mendojmë: ku po shkojmë si shoqëri?



Të fajësosh vetëm televizionin dhe kompjuterin dhe të përqendrohesh vetëm tek ato, do të ishte një qëndrim i gabuar. Nuk duhet harruar kurrë mësimdhënien e familjes dhe të rrethit shoqëror. Sa është e arsyeshme të fajësosh vetëm televizionin kur një fëmijë që është dëshmitar i afërt i dhunës në shtëpi shfaq sjellje të dhunshme ose tërhiqet në vetvete

për shkak të kësaj dhune? Nuk duhet harruar se frika, tensioni dhe shqetësimi që do të përjetojë një fëmijë kur është dëshmitar i babait të tij që e rreh nënën, do të kenë një ndikim më të madh sesa qindra skena vrasjesh që mund të shohë në televizor.

Si përfundim, përgjegjësia më e madhe për t'i mbrojtur fëmijët tanë, që janë thesari ynë, nga dhuna, bie mbi prindërit. Për ta përmbushur këtë përgjegjësi siç duhet, jo vetëm që duhet të jemi të informuar për çështjen, por gjithashtu duhet të përpiqemi vazhdimisht ta njohim dhe ta kuptojmë drejt e mirë botën e fëmijëve tanë.